REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. 11534 REP.
NR. 1112 KOL.

REPUBLIKA E SHQIPERISE NOTERE A. ROBO TIRANE

## KONTRATE DHURIMI

*Sot ne Tirane me date 26/9/2005 (dymije e pese) perpara meje noteres se Dhomes se Notereve, Tirane A. Robo, u paraqiten personalisht palet e meposhtme:*

(i) **Znj. Ilda Pepa (Thana)**, shtetase shqiptare, lindur me date 15.04.1968, banuese ne Tirane, mbajtese e pasaportes me nr. 2179202, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, dhe

(ii) **Z. Egres Thana**, shtetas shqiptar, lindur me date 27.07.1974, banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes me nr. 2068161 3, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar,

(te gjithe se bashku ne cilesine e ***Dhuruesit***)

**Dhe**

**Znj. Violeta Thana**, shtetase shqiptare, lindur ne Shkoder me 11.01.1947, banuese ne adresen: Rr. "Irfan Tomini", Tirane, madhore e me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e pasaportes me nr. 2077 5 2 24 (ne cilesine e ***Pranuesit***)

**MEQENESE**

a) I ndjeri **Fatmir Thana** ka qene titullar i 600 (gjashteqind) aksioneve te shoqerise SIGMA SH.A, shoqeri anonime e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 20487 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane qe perfaqesojne 2% te kapitalit te kesaj shoqerie, siç rezulton dhe vertetohet nga dokumentet e shoqerise.

b) Gjykata e Shkalles se Pare, Tirane, me vendimin nr. 5688, date 23.11.2004, ka shpallur si trashgimtare ligjore te te ndjerit Fatmir Thana: (i) Znj. Violeta Thana (e shoqja); (ii) Znj. Ilda Pepa (Thana) (e bija); dhe (iii) Z. Egres Thana (i biri), duke i njohur si bashkepronare ne kuota te barabarta (1/3 secili) te te gjitha pasurive e luajtshme dhe te paluajtshme te te ndjerit, dhe si rrjedhim dhe te aksioneve te zoteruara prej ketij te fundit ne shoqerine SIGMA SH.A.;

c) Dhuruesit deshirojne te transferojne ne favor te Pranuesit pa kundershperblim pjeset ne bashkepronesi mbi aksionet e shoqerise SIGMA Sh.a., te zoteruara nga i ndjeri Fatmir Thana;

**ATEHERE**

Palet bien dakort per sa me poshte vijon:

**Neni 1. Objekti i Kontrates**

Sipas kushteve te parashikuara ne kete Kontrate, Dhuruesit i dhurojne Pranuesit dhe ky i fundit pranon prej tyre te gjitha pjeset ideale qe Dhuruesit trashegojne nga i ndjeri Fatmir Thana ne lidhje me aksionet qe ky i fundit i zoteronte ne shoqerine SIGMA SH.A.

**Neni 2. Transferimi i Titullit**

Nepermjet nenshkrimit te kesaj kontrate, Pranuesi pranon te behet i vetmi titullar i ligjshem i 600 (gjashteqind) aksioneve te zoteruara nga bashkeshorti i saj, i ndjeri Fatmir Thana ne shoqerise SIGMA SH.A, qe perfaqesojne 2% te kapitalit te kesaj shoqerie, dhe Dhuruesit zhvishen nga çdo e drejte mbi keto aksione.

**Neni 3. Te Ndryshme**

Kjo Kontrate Dhurimi, se bashku me dokumentet qe i bashkengjiten, perbejne te gjithe marreveshjen midis paleve ne lidhje me objektin e mesiperm.

**Neni 4. Ligji i Zbatueshem**

Palet bien dakort qe kjo Kontrate do te zbatohet dhe interpretohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Per cfare nuk parashikohet ne kete Kontrate aplikohen dispozitat e Kodit Civil te Republikes se Shqiperise mbi dhurimin.

***Kjo Kontrate Dhurimi e cila hartohet ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe, pasi i lexohet paleve me ze te larte nga une Noteri, dhe pasi ata e gjeten permbajtjen e saj ne perputhje te plote me vullnetin e tyre te lire, e nenshkruajne para meje dhe une Noteri e vertetoj nenshkrimin e tyre sipas ligjit.***

**Dhuruesit:**

**Ilda Pepa (Thana)**

ILDA PEPA (THANA)

**Egres Thana**

EGRES THANA

**Pranuesi:**

**Violeta Thana**

Violeta Thana

**NOTERI**

PULLE TAKSE 50 LEKE SHQIPERISE